

Një fëmijë 4-vjeçar është kthyer në simbol të konfliktit në Gaza. Yamin Abu Jabir është i vetmi i mbijetuar nga famija e tij. Ashtu si 22 pjesëtarët e tjerë të familjes, edhe Yamin mendohej se kishte vdekur mes rrrënojave, pasi trupi i tij nuk u gjet asnjëherë. Kështu që të afërmit e tjerë nisën kërkimet në spital. I deklaruar i vdekur, ashtu si pjesa tjetër e familjes, vogëushi u gjet në një spital pas 5 ditë kërkimesh, në gjendje të shpërfytyruar dhe me njërin krah të fashuar.

“Kur spitali i parë ku u dërgua Yamin u bombardua, e mora në krah dhe e dërgova në spitalin e Shifa”, thotë Muhammad Abu Zeid, një vullnetar që qëndroi pranë të voglit me shpresën se ndonjë i afërm do të mund ta merrte.

Muhamed Xhabir Abu, një i afërm i babait të Yamin tha se besonte se fëmija kishte vdekur, pasi nuk e kishte gjetur nën rrënoja. Muhammad tregon historinë e familjes së Yamin, të cilët ishin mbledhur të martën, ditën e dytë të festës së Bajramit, në përpjekje për të krijuar një atmosferë pozitive dhe për të zbutur sadopak tensionin dhe frikën e shkaktuar nga sulmet ajrore izraelite.

Por ky gëzim ishte i përkohëshëm pasi u ndërpre nga një raketë izraelite që vrau 22 anëtarët e familjes së Yaminit 4-vjeçar. Familja e Yamin u vranë nga një sulm ajror izraelit në shtëpinë e tyre në tyre në kampin e refugjatëve Al-Bureij në Rripin e Gazës. Ofensiva ushtarake izraelite në Gaza ka marrë jetën e 400 fëmijëve, përveç mijërave të tjerë të dëmtuar./shqiptarja/